

Tirane

25/10/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Raport i fakteve te gjetura mbi Auditimin Ligjor të Fondeve të Përfutuara dhe të Shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2022 nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare

Ne kemi kryer procedurat e rena dakort me ju ne kontraten me Nr.7002 Prot datë 27.09.2023 e lidhur ndermjet paleve, qe do te pershkruhen me poshte, lidhur me fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2022 nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare

Procedurat u kryen vetem per t'ju ndihmuar juve qe te percaktoni fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2022 nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare te cilat jane permbledhur me poshte :

1. Ne morem nga KQZ kontraten Nr.7002 Prot datë 27.09.2023 per kryerjen e auditimit ligjor te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara ne vitin 2022 nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare
2. Ne derguam me poste Rekomande me Lajmërim Marrje: RR 524366526AA dt 11/10/2023 “ Kerkese per dergim te dhenash Partise Reformave Demokratike Shqiptare ne adresen Rr “Muhamet Gjollesha” ish shtypshkronja 8 Nentori,kati 3,zyra nr.30 ,Tirane .

Ne raportoyme gjetjet tona si me poshte :

Ne lidhje me piken 2 ne konstatuam se : Zarfi me kerkesen per dergim te dhenash eshte marr ne dorezim ne date 13.10.2023,dhe na kontaktoi Z.Krenar Rryçi,i cili na informoi se partia nuk ka fonde te perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2022,sipas deklarates bashkengjitur.

Si konkluzion per shkak se procedurat e mesiperme nuk perbejne auditim dhe as rishikim te bere ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ne nuk mund te shprehim asnje opinion per fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2022 nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare.

Audituese Ligjore

Silvana Gjikhima



Stamp: GJIKHIMA
LIGJENSA NR 162
32202008F

17.10.2023

Deklarimet e Partisë Reformave Demokratike Shqiptare

Për audituesen Ligjore : Zj. Silvana Gjikhima

Kjo letër e deklarimeve jepet në përgjigje të kërkesës tuaj date 11.10.2023 për informacion në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2022, nga partia Reformave Demokratike Shqiptare, autorizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Lidhur me kërkesën dhe informacionin e kërkuar nga ana juaj une, kryetar i kesaj partie, deklaroj me pergjegjesi te plote se Partia Reformave Demokratike Shqiptare gjate periudhes 1 Janar 2022-31 Dhjetor 2022:

- Nuk ka patur hyrje nga asnje burim të ardhurash, si kuotat e antarësise, financime nga buxheti i shtetit, financime nga donatore te huaj dhe vendas, hua, burime në natyre apo kompesime shpenzimesh.
- Nuk ka pasur burime materiale dhe financiare të trasheguara nga viti 2021.
- Nuk ka realizuar asnje blerje mallrash e sherbime për llogari të partise nga operatorë tregtarë dhe individ dhe nuk kemi berë pagesa ndaj tyre.
- Nuk ka pasur të punesuar dhe për rrjedhim shpenzime për paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore.
- Nuk ka kontrata për ambiente me qera apo huaperdorje.
- Nuk ka të hapur asnje llogari bankare ne bankat qe veprojne ne shqiperi dhe jashte saj.

Ne kushtet e mungeses së transaksioneve ekonomike dhe financiare ne kemi dorezuar Pasqyrat Financiare me vlere zero që kerkohen nga KQZ-ja.

Konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Për Partinë Reformave Demokratike Shqiptare
Kryetari:

Krenar Rexhi

